



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:279539
Datë: 05.08.2024
Numri i dokumentit: 06019163

Kom.Dh.Shk.II.nr.512/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS– Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Banka Ekonomike Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: 1. “Baki” Sh.P.K. me përfaqësues N.H., me adresë në Mitrovicë, rr. “Vlora”, 2. N.H. me nr. personal 1500867716, me adresë në Shipol- Mitrovicë, 3. “I & B Group” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. KDQ Tregatre, e përfaqësuar nga I.H., 4. I.H. B.I. me nr. identifikues 810566961, me adresë në Mitrovicë, rr. “Vlora”, 5. I.H. me adresë në fshatin Shipol-Mitrovicë, me nr. personal ..., 6. “LN Parc” Sh.P.K., me seli në Mitrovicë, rr. “Mbretëresha Teutë”, i përfaqësuar nga L.N. dhe 7. L.N. me nr. personal ..., me adresë në Mitrovicë, rr. ”Sylë Vokshi”, të gjithë të përfaqësuar me autorizimi nga Agron Krasniqi, avokat nga Prishtina, me objekt përmbartimi pagesën e kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2115/2022 të datës 27.11.2023, me datën 05.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorëve : 1.“Baki” Sh.P.K., 2. N.H., 3.“I & B Group” Sh.P.K., 4.I.H. B.I, 5.I.H., 6. “LN Parc” Sh.P.K. dhe 7. L.N., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2115/2022 të datës 27.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2115/2022 të datës 27.11.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve të përmbartimit 1.“Baki” Sh.P.K., 2. N.H., 3.“I & B Group” Sh.P.K., 4.I.H. B.I, 5.I.H., 6. “LN Parc” Sh.P.K. dhe 7. L.N., i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.712/2022 të datës 10.06.2022, i

lejuar nga Përmbauesit Privat Atip Mustafa, në pikën II e ka lënë në fuqi urdhërin përmbaimit P.nr.712/2022 të datës 10.06.2022, i lejuar nga Përmbauesit Privat Atip Mustafa.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë kanë parashtruar debitorët për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbaimore, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit në tërësi si e bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi KPPP.nr.2115/2022 të datës 27.11.2023 si dhe të obligohet kreditori të paguaj të gjitha shpenzimet procedurale.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në ankesë, duke propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e debitorit dhe aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2115/2022 të datës 27.11.2023, të mbetet në fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Zyra Përmbaimore e përmbauesit privat Atip Mustafa me seli në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbaimit me të cilin ka lejuar përmbaimit në bazë të : Marrëveshjes mbi pengun nr. 276334 e datës 12.11.2020 e siguruar nga Marrëveshja mbi kredinë për biznes nr.276334 e datës 12.11.2020, e Konfirmimit e Regjistrimit të pengut R-20201113-19 të datës 13.11.2020, mbi borxhin total prej 18,233.85 euro, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës përmbaimore.

Kundër propozimit për përmbaimit, prapsim ka paraqitur debitori në afat të rregullt ligjor, me të cilin ka theksuar se debitori me anë të këtij prapësimi në tërësi e kundërshton urdhrin e përmbauesit privat për arsye se nuk qëndrojnë asnjë nga arsyet që parashihen me LPP-në. Me tej të njëjtit kanë shtuar se nuk plotësohen as kushtet nga neni 167 të LPDTS, pasi që sekuestrimi i kolateralit pa dëgjimin e debitorëve është i papranueshëm, pasi që debitorët kanë të drejtën e tyre për mjete juridike.

Kreditorët brenda afat ligjore kanë paraqitur përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar pretendimet e debitorëve, dhe duke propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorëve si i pa bazuar.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit dhe përgjigje në prapësim të kreditorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimit KPPP.nr.2115/2022 të datës 27.11.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve të përmbaimit 1.“Baki” Sh.P.K., 2. N.H., 3.“I & B Group” Sh.P.K, 4.I.H. B.I, 5.I.H., 6. “LN Parc” Sh.P.K. dhe 7. L.N., i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbaimit numër P.nr.712/2022 të datës 10.06.2022, i lejuar nga Përmbauesit Privat Atip Mustafa, në pikën II e ka lënë në fuqi urdhërin përmbaimit P.nr.712/2022 të datës 10.06.2022, i lejuar nga Përmbauesit Privat Atip Mustafa.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarimore. Konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore të procedurës përmbarimore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ka konstatuar drejtë faktin se urdhri për lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat bazohet në : Marrëveshjes mbi pengun nr. 276334 e datës 12.11.2020 e siguruar nga Marrëveshja mbi kredinë për biznes nr.276334 e datës 12.11.2020, e Konfirmimin e Regjistrimit të pengut R-20201113-19 të datës 13.11.2020, mbi borxhin total prej 18,233.85 euro, të cilat dokumente mbi hipotekën paraqesin titull ekzekutiv në mbështetje të nenit 21,22 par 1.7 dhe 27 të LPP-së, për të qenë të përmbarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbarim. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar dokumentet përmbarimore marrëveshjeve për kredinë, respektivisht hipotekën, mbi në bazë të të cilave përmbaruesi privat ka zbatuar përmbarimin, të cilat dokumente përmbaruese përbejnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par. 1.7 dhe 27 i LPP-së, për të qenë të përmbarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbarim.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të atakuar, mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit sa i përket asaj se kemi të bëjmë me shkelje nga neni 21 të ligji të pengut, gjithashtu edhe nuk plotëson kushtet nga neni 182.1 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 29 të LPP-së. Andaj ka propozuar që aprovohet në tërësi kjo ankesë dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.2115/2022 të datës 27.11.2023.

Lidhur me pretendimet ankimore Dhomat e Shkallës së Dytë gjejnë se asnjë nga pretendimet e debitorit nuk gjen mbështetje ligjore dhe se kemi të bëjmë me dokumente që nuk janë të besueshëm sipas nenit 29 të LPP-së dhe marrëveshja nuk është e noterizume siç kërkohet me nenin 22 të LPP-së.

Duke e shqyrtuar aktvendimin e ankimuar në raport me të gjitha pretendimet ankimore, gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë gjejnë se të njëjtat janë të pa bazuara. Me nenin 71 të LPP-së, janë paraparë shkaqet të cilat prapësimin e paraqitur ndaj aktvendimit për lejimin e përmbarimit do ta bënë të bazuar, andaj duke pasur parasysh se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga arsyet e parapara në nenet e lartcekura, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë

Numri i lëndës: 2023:279539
Datë: 05.08.2024
Numri i dokumentit: 06019163

Kom.Dh.shk.II.nr.512/24, me datë 05.08.2024

**Gjyqtarin
Faton Bajrami d.v.**